



MERR MASA DRASTIKE... MOS PËRDOR QESE PLASTIKE!

Thuaji JO qeseve plastike!

Plastika përbehet nga polietileni dhe nxirret nga nafta bruto. Qeset e zakonshme polietilene, që merren në supermarkete e kudo në tregjet e zakonshme, përdoren gjerësisht nga konsumatorët e të gjitha moshave. Rezistente ndaj ujit, të lehta, dhe të lira, duket sikur ato janë një mrekulli e kohëve moderne, dhe e vetmja gjë shqetësuese është kur i shohim të hedhura pa kujdes nëpër pemë, kanale e trotuare. Por, këto veti në të njëjtën kohë janë edhe sfida, duke



qenë se plastika është material i padekompozueshëm. Një qese plastike e zakonshme, kërkon

një periudhë prej 1000 vjetësh që të dekompozohet, pra një mijëvjeçar... Për më tepër, meqenëse qeset plastike nuk zhduken, ato me kalimin e kohës dhe nën veprimin e agentëve të jashtëm, copohen në copa gjithnjë e më të vogla toksike petropolimere duke u shpërndarë në ujë, tokë dhe zinxhirin ushqimor.

Sipas revistës "National Geographic" në vit përdoren nga 500 bilion deri në 1 trilion (= 1 milion millionë) qese plastike në botë.

Kjo do të thotë, se ne po e mbulojmë planetin tonë me materiale plastike të padekompozueshme me një shpejtësi marramendëse...

Çmimi i vertetë i qeseve...

Çmimi i vertetë i qeseve plastike që jepen falas për çdo produkt që blihet, duke u parë nga një këndvështrim tjetër, mund të përkufizohet, si:

- Ndotje mjedisore nga përdorimi i kimikateve toksike gjatë prodhimit, të tilla si gazi, nafta dhe qymyri;
- Prodhimi i tyre kërkon gjithashtu konsumin e një sasive të madhe energjie;
- Ndotje mjedisore pas përdorimit nga konsumatorët, duke u hedhur dhe shpërndarë nëpër toka, pyje, lumenj, dete e oqeanë;
- Vetëm 1% e qeseve të prodhuara është e riciklueshme; dhe riciklimi kushton shumë më shumë se prodhimi i tyre;
- Ndotje oqeanike me një përlllogaritje prej 46,000 copa plastike për metër katror;
- 1 milion shpendë dhe 100,000 gjitarë deti ngordhin çdo vit duke u ushqyer me copëza plastike, të cilat i ngatërrojnë me copëza ushqimi.



*) www.cleanup.org.au dhe artikulli "Say no to plastic bags" në: www.suite101.com

**) Fotot: www.images.google.com

Si të ulim përdorimin e tyre?

Për të ulur përdorimin e qeseve plastike përveç faktit që mund t'i thonit JO përdorimit të tyre, ju mund të:

- Përdorni një çantë rrobe ose prej një materiali tjetër të riciklueshëm për blerjet tuaja;
- Nqs keni bërë një porosi të madhe në një dyqan ushqimor kërkonti që produktet të paketohen në një çantë të vetme rrobe ose letre që është e riciklueshme;
- Hidhni qeset në vendet e caktuara për mbeturinat;
- Ri-përdorni çdo qese plastike sa më shumë që të jetë e mundur;
- Kurseni sa më shumë përdorimin e qeseve plastike në jetën e përditshme;
- Flisni më të afërm, miq dhe kolegë për dëmet ekologjike të qeseve plastike.



Shumë vende kanë ndaluar përdorimin e qeseve plastike, ose kanë marrë masa për uljen e përdorimit të tyre. Të tilla shtete janë: Irlanda, Bangladeshi, Kina, Rwanda, Izraeli, Kanadaja, Kenia, Tajvani, Singapori, si dhe shumë vende të BE-së. Të tjera vende, lejojnë vetëm blerjen e qeseve plastike, duke reduktuar pothuajse me 90% përdorimin e tyre.

Fushata Ndërgjegjësuese: "Mbroje Mjedisin Tënd... Angazhohu si Vullnetar!" ndërmerret në kuadër të 5 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarëve. Kjo ditë festohet në të gjithë botën, duke vlerësuar kontributin e qindra dhe mijëra vullnetarëve anembanë globit, në emergjenca civile e natyrore, zhvillim social e njerëzor dhe sidomos në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. 5 Dhjetori 2009 është një thirrje për të gjithë për t'u angazhuar si vullnetar në mbrojtje të planetit.

Për më shumë informacion vizitoni: <http://unv.undp.org.al>



MERR MASA DRASTIKE...
MOS PËRDOR QESE PLASTIKE!



MBROJE MJEDISIN TËND!

Në Shqipëri

1 ♣ = minimumi 1 qese/ditë = 30 qese/muaj = 365 qese/vit
2,000,000 ♣ ♣ = 730 milion qese/vit = 21,900,000,000 qese në
30 vitet e ardhshëm
= 800,000 qese/m² në vitin 2040